

7.2 PRINTIMI I ETIKETAVE

Për fushat 996/997, mund të printoni etiketat. Përmbajtja e etiketës është në varësi nga të dhënat që i keni futur dhe vlera e treguesit të vendosjes:

- 1,3,5,7 – vendosja sipas numrit në vazhdim,
- 2,4,6,8 – vendosja sipas lëndës,
- 2,4,6,8 – vendosja sipas lëndës dhe numrave në vazhdim.

Procedura

1. Në redaktuesin **Fusha 996/997**, klikoni butonin **Printo etiketat**.

Dritarja **Printimi i etiketave për materialin** do të hapet.

Te "Printimi i etiketave" mund të përzgjidhni:

- *printerin* për printim të menjëhershëm të etiketës,
- radhën e raportit të përgatitur të cilin do ta dërgohet më vonë në printer,
- *pa printim*.

Vlera e parazgjedhur është *printeri*. Nëse këtë e ndryshoni, do të ruhet një vlerë e përzgjedhur e re.

Te "Lloji i etiketës", në bibliotekat, të cilat printojnë forma të ndryshme të etiketave, mund të përzgjedhin formatin përkatës të etiketës. Format i etiketës që printohet më së shpeshti, është përcaktuar në skedarin e konfigurimit si vlerë e parazgjedhur. Nëse vlerat i ndryshoni, do të ruhet vlera e përzgjedhur rishtas.

Nëse është i nevojshëm printimi i më shumë etiketave, do të shkruani numrin përkatës të "Numri i kopjeve".

2. Klikoni butonin **Në rregull**.

Etiketa do të printohet në printer.

Nëse e keni përzgjedhur mundësinë e printimit përmes radhës së raportit, etiketat do të shtohen në radhën e raportit të përzgjedhur. Printimi nga radha e raportit është përshkruar në manualin *COBISS3 Udhëzime themelore, shih kapitullin 4.6.4*.

Mundësitë...

Etiketat mund të printoni ashtu që në klasën **Fusha 996/997** kërkonte fushën 996/997 dhe përzgjidhni metodën **Objekti / Printo etiketat**, ose metodën **Objekti / Printo** ose metodën **Objekti / Dërgo**. Dërgimi i raportit është përshkruar në manualin *COBISS3 Udhëzime themelore, shih kapitullin 4.5*.

Printimi i etiketave është edhe hapi i fundit në metodën **Objekti / Inventarizo** të botimet monografike, si dhe në metodën **Klasa / Kontrolli i ardhjes së serialeve** të serialet, kur në fushat 997evidentoni vëllimet e pranuar.